



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR KËRKIMIN
SHKENCOR, TEKNOLOGJINË DHE INOVACIONIN 2023-2030 DHE
TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” propozohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), si një dokument politik i qeverisë shqiptare, e cila i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të arsimit, si një e drejtë themelore kushtetuese dhe përgjegjësi publike, nëpërmjet të cilës synohet të krijohen, zhvillohen dhe të mbrohen dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, formimit të specialistëve të lartë dhe të shkencëtarëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend. MAS mbështet prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit, integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë, në kuadër të zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal.

Qëllimi i këtij dokumenti strategjik është të përcaktojë objektivat afatmesme të Qeverisë për arritjen e vizionit për arsimin të përcaktuar në SKZHI-në e miratuar me vendimin nr. 88, datë 22.2.2023, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”: *“Një sistem arsimor që ka për bazë nevojat dhe interesat e nxënësve; që krijon kushtet*

dhe mundësitë për studentët për të ndërtuar dhe zhvilluar njohuritë e tyre, aftësitë dhe vlerat e kërkuara nga shoqëria; që lejon nxënësit të zhvillohen në mënyrë të pavarur dhe për të kontribuar për mirëqenien e tyre dhe të shoqërisë dhe në mënyrë konstruktive të përballen me sfidat e jetës”.

Në dokument janë përcaktuar tre qëllimet e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030:

1. Qëllimet e politikave dhe objektivat specifikë të SKKSHTI 2023-2030

Ky qëllim është pasqyruar në disa objektiva të përcaktuar si më poshtë:

- a) Objektivi Specifik 1.1: Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të garantuar cilësinë, etikën dhe efektivitetin në zhvillimin dhe aplikimin e kërkimit në përputhje me fushat prioritare
- b) Objektivi Specifik 1.2: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- c) Objektivi Specifik 1.3: Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit dhe publikimi i treguesve statistikorë dhe të tjerë të kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit.

2. Qëllimi i Politikës 2: Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike

Ky qëllim është pasqyruar në disa objektiva të përcaktuar si më poshtë:

- a) Objektivi Specifik 2.1: Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta. (Quadruple Helix Model).
- b) Objektivi Specifik 2.2: Përmirësimi i mekanizmave dhe rritja e mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë (TNT).
- c) Objektivi Specifik 2.3: Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik.

- d) Objektivi Specifik 2.4: Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë.
3. Qëllimi i Politikës 3: Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikat kërkimore dhe projektet.
- a) Objektivi Specifik 3.1: Reformimi i kurrikulës në arsimim parauniversitar duke përfshirë në edukim informacion për shkencat, teknologjinë, inxhinierinë dhe matematikën (STEM).
- b) Objektivi Specifik 3.2: Sensibilizimi në të gjitha nivelet e edukimit parauniversitar, për fuqizimin e rolit të të rinjve në kërkim dhe inovacion.
- c) Objektivi Specifik 3.3: Zhvillimi i kompetencës digjitale.

Në projekt-Strategji në pjesën IV parashikohet zbatimi, llogaridhënia dhe koordinimi i institucioneve

Në projekt-Strategji në pjesën V parashikohet : Plani i Veprimit dhe Vlerësimet Financiare

Në aneksin 1 përcaktohet plani i veprimit i kostuar

Në aneksin 2 përcaktohet treguesit e monitorimit të dokumentit të Strategjisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030 lidhet dhe harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim III, me *Shtyllën 3 të kësaj strategjie: “Investimi në Kapitalin Njerëzor dhe Kohezionin Social”*, ‘Më shumë mundësi dhe më shumë cilësi në arsim’,

Projektvendimi është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për t’u miratuar në katërmujorin I të vitit 2023, në zbatim të vendimit nr. 862, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave

“Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”.

Bazuar në nenin 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", që përcaktojnë rregulla për veprimtaritë publike të institucioneve në periudhën 4 (katër) muaj përpara datës së zgjedhjeve dhe referuar shkresës nr. 139 prot., datë 11.01.2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me lëndë: "Kujtesë mbi veprimtarinë e institucioneve publike 4 (katër muaj) përpara datës së zgjedhjeve", ky projektvendim nuk përcakton zhvillimin e veprimtarive të ndaluar për t'u promovuar, me të cilat konsiderohen ato veprimtari publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Ky projektvendim, që propozohet për miratim, nuk përfshihet në kategorinë e akteve të ndaluara në kuptim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve".

Projektakti i propozuar është në harmoni me programin e Qeverisë Shqiptare, në fushën e arsimit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Viti 2022 ishte viti i fundit i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022. Në këtë kontekst, MAS mori vendimin për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe

Inovacionit 2023-2030, që pasqyron përpjekjet e vazhdueshme të qeverisë shqiptare për të rritur si nga ana sasiore, ashtu edhe nga ana cilësore kërkimin shkencor dhe inovacionin, si dhe përdorimin e teknologjisë në të gjithë nivelet e arsimit dhe institucionet, aktiviteti i të cilave ndikon në kërkim, teknologji dhe inovacion. Ky dokument siguron harmonizimin e politikave afatmesme në të gjitha nivelet e arsimit, nga ai parashkollor deri në arsimin e lartë. Gjithashtu në këtë dokument përfshihet si pjesë integrale edhe kontributi që jepet edhe nga institucionet qendrore.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencën dhe Inovacionin 2023-2030 është: *“Deri në vitin 2030, Shqipëria do të sigurojë kërkim shkencor cilësor për një zhvillim socio-ekonomik të qëndrueshëm gjithëpërfshirës dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, bazuar në njohuritë e reja shkencore dhe risitë në teknologji dhe inovacion.”*.

Strategjia do të jetë pjesë përbërëse e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) sipas urdhrit nr. 157, datë 22.10.2018 të Kryeministrit *“Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”*. Ky mekanizëm është në funksion të Sistemit të Planifikimit të Integruar si sistemi kryesor që përcakton mjetet dhe mekanizmat për një planifikim të integruar të politikave publike. SPI funksionin nëpërmjet Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) dhe Komitetet Drejtuese Sektoriale (KDS), anëtare e së cilave është MAS sipas përcaktimeve të këtij Urdhri.

Në aspektin e integritimit në BE, dokumenti i Strategjisë është në koherencë të plotë me parimet e përcaktuara në Dispozitat e Traktatit mbi Funksionimin e BE (TFBE) Kapitulli XIX mbi Kërkimin.

Ky dokument strategjik është planifikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025 dhe duhet të miratohet brenda 3 mujorit të IV të vitit 2023.

Sipas *“Raportit të Progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë të vitit 2022”*, kapitulli 25 është pjesë e konkurrencës dhe rritjes së qëndrueshme të grupit 3. Në lidhje me këtë kapitull rekomandimet kryesore të BE-së janë si më poshtë:

- Rritja e investimeve në fushën e kërkimit shkencor në përputhje me angazhimet kombëtare dhe prioritetet e ERA-s.

- Të prodhojë të dhëna dhe statistika të besueshme në fushën e kërkimit dhe teknologjinë duke përfshirë treguesin e investimeve të brendshme bruto për kërkimin dhe zhvillimin.

Brenda këtij kuadri sfidat që mbeten aktuale përfshin shtimin e investimeve në kërkim shkencor dhe inovacion në Shqipëri.

Për politikën e kërkimit dhe inovacionit, me Urdhrin nr. 425, datë 02.11.2021 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit u krijua një grup pune ndërinstitucional në vitin 2021, për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit 2017 – 2022.

Përveç kësaj, strategjia e re për kërkimin shkencor duhet të zhvillohet dhe miratohet. Pra, në shkurt 2022, me urdhër nr. 53, datë 9.02.2022, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupit koordinues për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit” krijohet një grup i ri pune ndërinstitucional. Gjithashtu në zbatim të urdhrit nr. 336, datë 15.06.2022, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, “Për krijimin e grupeve teknike të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor 2023 – 2030”, janë ngritur grupet teknike të punës. Procesi mbështetet nga dy ekspertë të ofruar nga EU4Innovation.

Strategjia adreson prioritetet e PKIE-së të lidhura me sigurimin e cilësisë: “*Sigurimi i cilësisë bazuar në standarde të krahasueshme me ato të vendeve të BE-së*”.

Në vijim është dhënë një përmbledhje e faktorëve politikë, ekonomikë, socialë dhe teknologjikë me ndikim të supozuar në zhvillimet në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit mbi të cilën është mbështetur analiza për hartimin e dokumentit strategjik.

Faktorët politikë:

- Financimi i kërkimit shkencor, përdorimit të teknologjisë dhe nxitjes së inovacionit ka zënë vend të rëndësishëm në agjendën politike të Republikës së Shqipërisë.

- Përmirësimi i cilësisë së kërkimit shkencor është përparësi në programin qeverisës dhe ndërlidhet me zhvillimet në fushën e arsimit.
- Avancimi në procesin e integritit evropian i lidhur drejtpërdrejtë me Kapitullin 25 kërkon përmirësime në sistemin e kërkimit shkencor, në mënyrë që vendi t'i përmbushë kriteret për anëtarësim.

Faktorët ekonomikë

- Të gjitha analizat në nivelin makro tregojnë se Republika e Shqipërisë do ketë vështirësi si pasojë e luftës që po zhvillohet në Ukrainë.
- Zhvillimet në teknologji dhe inovacion sjellin pasoja me impakt pozitiv në rritjen ekonomike të vendit.

Faktorët socialë

- Rënia e vazhdueshme e lindshmërisë dhe trendet e migrimit janë duke shkaktuar ndryshime në tablonë demografike.
- Gjatë dy viteve të fundit është dëshmuar se kur krijohen kushtet, kërkuesit në Shqipëri janë në gjendje të konkurrojnë denjësisht duke aplikuar dhe fituar në thirrje të thirrje të ndryshme.
- Trendet e emigrimit dhe atashimi i kërkuesve shqiptarë pranë Universiteteve të vendeve të BE kanë ndikuar në rritjen e bashkëpunimit midis kërkuesve shqiptarë dhe atyre nga diaspora.

Faktorët teknologjikë

- Me përhapjen e internetit është më e thjeshtë të ndiqen politika që nxisin kërkimin shkencor.
- Infrastruktura solide telekomunikuese.

Referuar problematikave të evidentuara si më lart, disa nga efektet (impakt) e pritshme ekonomike, sociale, politike dhe ndërsektoriale të masave të planifikuara në SKSHTI 2023-2030 janë:

Impakti social:

Strategjia kontribuon në:

- Formimin shkencor më cilësor të të gjithë individëve, duke ndikuar në mirëqenien personale të tyre.

- Zhvillimin e teknologjisë dhe projektet e mbështetura në inovacion do të ndikojnë në përmirësimin e jetës në shoqëri.

Impakti ekonomik:

- Përmirësim i cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në Republikën e Shqipërisë dhe rritjen e të ardhurave të tyre.
- Projektet kërkimore midis IAL-ve, biznesit dhe institucioneve qendrore do të sjellin impakt pozitiv në rritjen e investimeve
- Projektet kërkimore midis IAL-ve, biznesit dhe qeverisë do të sjellin impakt pozitiv në konkurrueshmërinë e bizneseve në tregun vendas dhe ndërkombëtar.

Impakt politik:

Strategjia kontribuon në:

- formimin cilësor të të gjithë individëve, me qëllim forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.
- Forcimin e vënien në zbatim të politikave qeveritare në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit

Impakti ndërsektorial:

- Përmirësim i bashkëveprimit midis institucioneve përgjegjëse për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe informacionin.

Treguesit kryesorë të impaktit të SKSHTI janë:

1. Indeksi evropian i inovacionit / Performanca e Shqipërisë në EU Innovation Scoreboard.
2. Përqindja e buxhetit të shtetit dedikuar për kërkimin shkencor.
3. Performanca e Shqipërisë në programin Horizon Europe.
4. IAL të rankuara sipas performancës së kërkimit shkencor.

Treguesi 1 jep renditjen e vendeve sipas suksesit dhe kapacitetit që kanë për inovacion. Parametrat që përdoren për ta llogaritur përfshijnë 'institucionet', 'kapitalin njerëzor dhe kërkimin', 'infrastrukturën', 'solistikimin e tregut',

'sofistikimin e biznesit', 'produktet e njohurive dhe teknologjisë ' dhe 'produktet e krijimit'.

Treguesi 2 adreson financimin e domosdoshëm të kërkimit shkencor.

Treguesi 3 jep ndryshimin çdo vit të performancës së Shqipërisë lidhur me aplikimin në programin Horizon Europë me impakt në përfitimin e fondeve nga ky program.

Treguesi 4 do të tregojë trendin e ndryshimeve lidhur me rankimin e IAL bazuar në kriteret që do të hartohen për të matur performancë në kërkimin shkencor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës.

Masat të cilat adresojnë arsimin parauniversitar dhe atë të lartë janë në harmoni me dy ligjet kuadër dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre:

- Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Në aspektin e integritimit në BE, dokumenti i Strategjisë është në koherencë të plotë me parimet e përcaktuar në Dispozitat e Traktatit mbi Funkcionimin e BE (TFBE), kapitulli XIX mbi kërkimin, por nuk lidhet me çështje konkrete të përafrimit me *acquis communautaire*. Projektakti është parashikuara në planin kombëtar për integrimin evropian të miratuar me vendim nr. 122, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030 jetësohet në tre qëllime kryesore të politikave. Për çdo qëllim janë identifikuar objektivat specifikë të cilët detajohen në masat që duhen marrë për të bërë të mundur arritjen e realizimit të secilit objektiv. Për secilin qëllim specifik të politikës janë dhënë treguesit të cilët ofrojnë informacion objektiv për progresin e zbatimit të Strategjisë.

Në të njëjtën kohë, qëllimet strategjike, objektivat specifikë dhe masat e parashikuara, janë shoqëruar me tregues për monitorimin e tyre si dhe me buxhetet përkatëse. Gjithashtu, jepet edhe sqarim më i hollësishëm për përmbajtjen e masave, afatet kohore, institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse, si dhe rezultatet e pritshme, pra për logjikën e ndërhyrjes në tërësi sipas formateve dhe standardeve të IPSIS.

Në vijim janë dhënë vizioni, qëllimet e politikave dhe objektivat strategjikë të propozuar:

Vizioni: Deri në vitin 2030, Shqipëria do të sigurojë kërkim shkencor cilësor për një zhvillim socio-ekonomik të qëndrueshëm gjithëpërfshirës dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, bazuar në njohuritë e reja shkencore dhe risitë në teknologji dhe inovacion..

- **Qëllimi i politikës 1:** Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e kërkimit shkencor, të integruar në nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane.
 - **Objektivi Specifik 1.1:** Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të garantuar cilësinë, etikën dhe efektivitetin në zhvillimin dhe aplikimin e kërkimit në përputhje me fushat prioritare;
 - **Objektivi Specifik 1.2:** Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse të kërkimit shkencor për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare.

- **Objektivi Specifik 1.3:** Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit dhe publikimi i treguesve statistikorë dhe të tjerë të kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit.
- **Qëllimi i politikës 2:** Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike.
- **Objektivi Specifik 2.1:** Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta. (Quadruple Helix Model)
 - **Objektivi Specifik 2.2:** Përmirësimi i mekanizmave dhe rritja e mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë (TNT).
 - **Objektivi Specifik 2.3:** Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik.
 - **Objektivi Specifik 2.4:** Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë.
- **Qëllimi i politikës 3:** Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikat kërkimore dhe projektet.
- **Objektivi Specifik 3.1:** Reformimi i kurrikulës së shkencës në arsimim parauniversitar duke përfshirë STEM në edukim.
 - **Objektivi Specifik 3.2:** Sensibilizimi në të gjitha nivelet e edukimit parauniversitar, për fuqizimin e rolit të rinjve në kërkim dhe inovacion
 - **Objektivi Specifik 3.3:** Zhvillimi i kompetencës digjitale

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin zbatohet në periudhën 2023-2030, ndërsa roli udhëheqës në zbatimin e saj i takon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) si institucion përgjegjës për fushën e

arsimit dhe kërkimit shkencor. Përgjegjësia për zbatimin e secilës masë është përcaktuar me planin e veprimit dhe ndahet ndërmjet MAS-it, institucioneve të saj të varësisë, institucioneve të arsimit të lartë, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe aktorëve të tjerë, siç jepen në mënyrë të detajuar tek **Aneksi 1: ‘Formati i planit të veprimit të përmbledhur’**. Për shkak të natyrës së masave duhet të ekzistojë një bashkërendim i mirë me nismat e partnerëve zhvillimorë të Qeverisë, ku bëjnë pjesë donatorët, si dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që, në një mënyrë ose tjetër, shprehin gatishmëri për kontribuar në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin.

MAS do të krijojë Grupin Koordinues për Zbatimin e Strategjisë, i cili do të drejtohet nga Ministri (ose Zëvendësministri në emër të tij/saj), dhe përbëhet nga zyrtarë përgjegjës të njësive organizative përkatëse të MAS, si dhe të institucioneve vartëse (DPAP, ASCAP, QSHA, ASCAL, AKKSHI) dhe institucioneve tjera përkatëse (RASH, AKSHI, etj.).

Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit do të realizohet sipas metodologjisë së konfirmuar nga njësia përgjegjëse në Kryeministri në zbatim të vendimit nr. 290, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPSI/IPSIS)”, i cili, ndër të tjera, është sistemi kryesor për monitorimin e performancës së arritur kundrejt politikave dhe objektivave të planifikuara në dokumentet strategjike.

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky dokument konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tij me qëllim përmbushjen e objektivave në mënyrë sa më efektive. Në pasaportat e indikatorëve, për secilin tregues është përcaktuar përgjegjësia për mbledhjen e të dhënave, ndërsa rolin mbikëqyrës dhe koordinues e ka MAS.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit është hartuar dhe koordinuar nga MAS me kontributin e Grupit të Koordinimit ngritur me urdhër nr. 53, datë 9.02.2022, të

Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupit koordinues për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit” krijohet një grup i ri pune ndërinstitucional. Gjithashtu në zbatim të urdhrit nr. 336, datë 15.06.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për krijimin e grupeve teknike të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor 2023 – 2030”, janë ngritur grupet teknike të punës.

MAS është mbështetur nga një grup ekspertesh, të ofruar nga EU4Innovation të cilët lehtësuan punën e Grupit të Koordinimit dhe Grupeve të Punës/tematike në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri te kostimi dhe përgatitja e pasaportës së treguesve.

Në kuadër të detyrimit të konsultimit publik, strategjia do të publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe në Rrjetin Elektronik të Konsultimit Publik, sipas detyrimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në këtë kuadër po zhvillohen një sërë takimesh publike/konsultative.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostimi i draft-Strategjisë “Për miratimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikës së planifikimit buxhetor, me qëllim përcaktimin e kostos shtesë për zbatimin e Strategjisë dhe hendekut financiar, në raport me fondet buxhetore të planifikuara në PBA 2023-2025 dhe nga financimi i donatorëve. Përlllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Hapi i parë në këtë proces ka qenë identifikimi i shpenzimeve për secilën masë dhe klasifikimi i tyre në kategori shpenzuese të paracaktuara. Për shpenzimet që përsëriten më shpesh janë përcaktuar kostot standarde përmes studimit të tregut dhe konsultimeve me ekspertë, p.sh. kosto për organizime të trajnimeve, paga, pajisje të ndryshme, materiale dhe shërbime si dhe investime të tjera kapitale. Më pas, është bërë përlllogaritja e kostos sipas viteve, duke bërë kujdes që hendeku për vitet 2023-2030 të jetë më shumë se 30% e kostos totale.

Kostoja totale për zbatimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin për periudhën 2023-2030 është në masën 27.5 miliardë lekë. Kosto mesatare vjetore e aktiviteteve të kushtuara për periudhën 2023-2030, në vitin 2023 parashikohet të arrijë në masën 0.084% ndaj produktit të brendshëm bruto, në vitin 2026 parashikohet të arrijë në masën 0.152% e PBB, si dhe në vitin 2030 synon të arrijë në masën 0.162% e PBB, e detajuar sipas qëllimeve të politikës së programit sa vijon.

Qëllimi i Politikës I: “Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e kërkimit shkencor, të integruar në nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane”, kosto të parashikuar për këtë qëllim strategjik është në masën 19.9 miliardë lekë ose 72% e fondeve të parashikuara për zbatimin e kësaj strategjie. Sipas burimeve të financimit, është parashikuar kosto buxhetore financim i brendshëm 12.6 miliard lekë, financim i huaj në masën 2.87 miliard lekë, si dhe hendeku financiar i pambuluar me fonde buxhetore apo financim nga donatorë është në masën 4.41 miliard lekë.

Qëllimi i Politikës II: “Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike”, kosto të parashikuar për këtë qëllim strategjik është në masën 6.37 miliardë lekë ose 23% e fondeve të parashikuara për zbatimin e kësaj strategjie. Sipas burimeve të financimit, është parashikuar kosto buxhetore financim i brendshëm 2.96 miliard lekë, financim i huaj në masën 0.03 miliard lekë, si dhe hendeku financiar i pambuluar me fonde buxhetore apo financim nga donatorë është në masën 3.38 miliard lekë.

Qëllimi i Politikës III: “Qëllimi i politikës 3 - Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikën kërkimore dhe projektet.”, kosto të parashikuar për këtë qëllim strategjik është në masën 1.25 miliardë lekë ose 5% e fondeve të parashikuara për zbatimin e kësaj strategjie. Sipas burimeve të financimit, është parashikuar kosto buxhetore financim i brendshëm 0.88 miliard lekë, financim i huaj në masën 0.33 miliard lekë, si dhe hendeku financiar i pambuluar me fonde buxhetore apo financim nga donatorë është në masën 0.03 miliard lekë.

Disa tregues të kostimit të strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin për periudhën 2023-2030, si kosto mesatare vjetore e aktiviteteve të parashikuar për periudhën 2023-2030, për vitin 2023 parashikohet të arrijë në masën 0.084% ndaj produktit të brendshëm bruto, në vitin 2026 parashikohet të arrijë në masën 0.152% e PBB, si dhe në vitin 2030 synon të arrijë në masën 0.162% e PBB.

Tabela 2: Kostimi i objektivave të strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin për periudhën 2023-2030, siaps aktiviteve të parashikuara për çdo aktivitet

Qëllimi i Politikës I: Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit për mbështetjen e kërkimit shkencor, të integruar në nivel ndërkombëtar, në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane											
Nr.	Titulli	Institucionet Përgjegjëse		Periudha e Zbatimit		Kosto indikative					
		Institucioni drejtues	Institucionet pjesmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Korente	Kapitale	Total Kosto	Total BSH	Total FH	Hendeku Financiar
1.1	I. Objektivi Specifik Plotësimi dhe zbatim i kuadrit ligjor dhe rregullator për të garantuar cilësinë, etikën dhe efektivitetin në zhvillimin dhe aplikimin e kërkimit në përputhje me fushat prioritarë	MAS, AKKSHI	. AKKSHI, IAL, MFE, ASCAL, ASHSH, RASH, ASHSH, ML	2023	2030						
1.1.1	1.1.1 Masa 1 Miratimi i ligjit të ri "Për Shkencën në Republikën e Shqipërisë"	MAS	AKKSHI, IAL, MFE, ASCAL, ASHSH	2023	2023	2,028,830	0	2,028,830	2,028,830	0	0
1.1.2	1.1.2 Miratimi i paketës së akteve nënligjore në zbatim të Ligjit të ri "Për Shkencën në Republikën e Shqipërisë"	MAS	AKKSHI, ASHSH, IAL	2024	2024	2,612,986	0	2,612,986	2,612,986	0	0
1.1.3	1.1.3 Zhvillimi i fushatave sensibilizuese për ligjin "Për Shkencën në Republikën e Shqipërisë".	MAS	AKKSHI, IAL	2024	2024	69,969	0	69,969	69,969	0	0
1.1.4	1.1.4 Masa 4 Krijimi i një Struktore Koordinuese Kombëtare për politikën mbi Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin	MAS	ML	2025	2025	1,670,925	0	1,670,925	95,928	0	-1,574,997
1.1.5	1.1.5 Masa 5 Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore lidhur me Statusin e Kërkuesit Shkencor	MAS	AKKSHI, ASHSH, RASH, IAL	2024	2025	1,797,700	0	1,797,700	1,797,700	0	0
1.1.6	1.1.6. Masa 6. Hartimi dhe miratimi i Kodi i Etikës në Kërkimin Shkencor	MAS	AKKSHI	2024	2025	1,540,445	0	1,540,445	1,540,445	0	0
1.1.7	1.1.7 Masa 7. Hartimi i kriterëve dhe treguesve për vlerësimin e kërkimit shkencor dhe renditja e IAL sipas performancës në kërkimin shkencor	MAS	AKKSHI	2026	2030	3,764,555	0	3,764,555	3,764,555	0	0
1.1.8	1.1.8 Masa 8 Rishikimi i akteve ligjore në kuadër të kapitullit 25 të BE "Shkenca dhe kërkimi shkencor"	MAS	AKKSHI, RASH, IAL	2023	2030	17,724,232	0	17,724,232	16,024,232	1,700,000	0
1.1.9	1.1.9 Masa 9 Rishikimi i kuadrit rregullator përfshirë atë institucional për kërkimin shkencor në kuadër të detyrimeve që burojnë nga procesi i asociimit në BE lidhur me kapitullin 25 të BE "Shkenca dhe Kërkimi Shkencor"	MAS	AKKSHI, ASHSH	2023	2030	32,989,757	0	32,989,757	1,189,757	31,800,000	0
1.1.10	1.1.10 Masa 10 Përmirësimi i akteve normative lidhur me përcaktimin e fushave prioritarë të kërkimit shkencor.	MAS	AKKSHI, IAL	2023	2030	11,872,020	0	11,872,020	11,272,024	0	-599,996
1.1.11	1.1.11 Masa 11 Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore që garantojnë aksesin në publikime të kërkuesve shkencorë të vendit për të qenë në linjë me strategjitë e Open Access që zbatohen në nivel evropian	AKKSHI	MAS, ASHSH, RASH, IAL	2024	2025	7,384,591	0	7,384,591	6,664,592	0	-719,999

Relacion shpjegues për projektvendimin, "Për miratimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj".

1.1.12	1.1.12 Masa 12 Hartimi i udhëzuesit për hartimin e planit për hendeqet gjinore në institucionet kërkimore shkencore (përfshirë IAL)	MAS	AKKSHI, IAL	2023	2030	20,064,000	0	20,064,000	0	2,400,000	-17,664,000
1.1.12	1.1.13 Miratimi dhe vënia në zbatim (funktionalizimi) i rregullores për krijimin e regjistrit kombëtar të revistave dhe periodikëve shkencorë dhe për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë revistat dhe periodikët shkencorë për t'u regjistruar në regjistrin kombëtar të Republikës së Shqipërisë.	MAS	IAL, AKKSHI, ASHSH, RASH	2023	2030	8,067,877	5,200,000	13,267,877	10,726,236	0	-2,541,641
Kosto Objektivi Specifik 1.1						111,587,887	5,200,000	116,787,887	57,787,254	35,900,000	-23,100,633
1.2	Objektivi Specifik 2 Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës mbështetëse në kërkimit shkencor për rritjen e performancës në programet kombëtare dhe ndërkombëtare.	AKKSHI, MAS	IAL, Institutet kërkimore pranë ML, AMSHC, MAS, MB, AKFAL, RASH, ASHSH, MK, ML	2023	2030						
1.2.1	1.2.1 Masa 1 Ngritja e kapaciteteve për shkrimin e projekteve kombëtare shkencore, në mënyrë që përmbajtja dhe arritjet e tyre të kontribuojnë në cilësinë, rëndësinë dhe efektivitetin e kërkimit dhe përmbushjen e qëllimeve strategjike në fushat prioritare.	AKKSHI	MAS, IAL, Ministria e Mbrojtjes	2023	2030	10,500,000	0	10,500,000	3,180,000	0	-7,320,000
1.2.2	1.2.2 Masa 2 Organizimi i ditëve informative dhe i aktiviteteve promovuese për thirrjet e projekteve në programe ndërkombëtare	AKKSHI	IAL, Institutet kërkimore pranë Ministrive të Linjës, AMSHC	2023	2030	8,064,000	0	8,064,000	5,760,000	0	-2,304,000
1.2.3	1.2.3 Masa 3 Trajnimi i stafeve akademike lidhur me aplikimin në programe ndërkombëtare	MAS	AKKSHI,	2023	2030	2,981,069	0	2,981,069	823,438	0	-2,157,631
1.2.4	1.2.4 Masa 4 Ngritja dhe forcimi i qendrave kombëtare shkencore të ekselencës që integrojnë studiues dhe burime kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar	AKKSHI	MAS/IAL	2023	2030	0	15,450,000,000	15,450,000,000	8,350,000,000	2,830,000,000	-4,270,000,000
1.2.5	1.2.5 Masa 5 Krijimi i Hartës Kombëtare të infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri në përputhje me ESFRI (European Strategic Framework of Research Infrastructure)	AKKSHI	MAS	2024	2026	3,663,813	50,000,000	53,663,813	2,463,813	0	-51,200,000
1.2.6	1.2.6 Masa 6 Forcimi i sistemit të shkencës dhe kërkimit shkencor përmes bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar	AKKSHI	MAS, IAL, ASHSH	2023	2030	12,902,400	0	12,902,400	12,902,400	0	0
1.2.7	1.2.7 Masa 7 Krijimi i rrjeteve të kërkuesve shkencorë brenda dhe jashtë Shqipërisë	AKKSHI	RASH	2023	2030	10,560,000	0	10,560,000	4,700,000	0	-5,860,000
1.2.8	1.2.8 Masa 8 Krijimi dhe përditësimi periodik i databazës së kërkuesve shkencore	RASH	IAL, AKKSHI, ASHSH	2024	2030	5,180,000	0	5,180,000	740,000	0	-4,440,000
1.2.9	1.2.9 Masa 9 Rritja e mbështetjes financiare për aplikimin në projekte kombëtare	AKKSHI	AKFAL, MK, ASHSH, AMSHC	2023	2030	4,005,201,563	6,325,000	4,011,526,563	4,001,241,560	0	-10,285,003

Relacion shpjegues për projektvendimin, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

1.2.10	1.2.10 Masa 10 Forcimi i kapaciteteve të pikave kombëtare të kontaktit (programi Horizon)	AKSHI (Fonde për Shkencën) /	MAS, ASHSH	2023	2030	9,840,000	0	9,840,000	0	0	-9,840,000
1.2.11	1.2.11 Zhvillimi i Platformës (online) të të dhënave për kërkimet shkencor në RSH, në lidhje me kapacitetet njerëzore, infrastrukurore, biblioteka dhe arkiva	MAS, RASH /	AKKSHI, IAL, MK, ASHSH	2026	2030	10,489,200	12,000,000	22,489,200	0	0	-22,489,200
	Kosto Objektivi specifik 1.2					4,079,382,045	15,518,325,000	19,597,707,045	12,381,811,211	2,830,000,000	-4,385,895,834
1.3	Objektivi Specifik 3 Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit dhe publikimi i treguesve statistikorë dhe të tjerë të kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit.	INSTAT, AKKSHI, ASPA	MAS, AKKSHI, Institucionet e kërkimit shkencor, IAL, MK,	2023	2030						
1.3.1	1.3.1 Masa 1. Hartimi i metodologjisë së mbledhjes së të dhënave statistikore në fushën e kërkimit shkencor	INSTAT	MAS, AKKSHI, Institucionet e kërkimit shkencor, IAL, MK	2023	2023	488,915	0	488,915	488,915	0	0
1.3.2	1.3.2 Masa 2. Hartimi dhe publikimi i të dhënave për kërkimin shkencor sipas periodicitetit të përcaktuar në Programin e statistikave Zyrtare 2022-2026	INSTAT	MAS, AKKSHI	2023	2030	204,234,810	1,750,000	205,984,810	204,234,810	1,750,000	0
1.3.3	1.3.3 Masa 3. Hartimi dhe publikimi i buletinit të përvitshëm për kërkimin shkencor	AKKSHI	MASR (Fonde për Shkencën)	2023	2030	1,071,423	0	1,071,423	1,071,423	0	0
1.3.4	1.3.4 Masa 4 Zhvillimi i kapaciteteve të stafit të MAS, AKKSHI dhe instituteve të tjera kërkimore për mbledhjen, analizën dhe raportimin e standardizuar të statistikave për kërkimin shkencor sipas standardeve ndërkombëtare (Eurostat, OECD).	ASPA	INSTAT	2024	2030	900,000	0	900,000	0	0	-900,000
1.3.5	1.3.5 Masa 5. Hartimi i treguesve të performancës mbi kërkimin shkencor me qëllim krahasimin në nivel evropian dhe ndërkombëtar	AKKSHI	MAS	2025	2030	3,339,434	0	3,339,434	683,279	0	-2,656,155
	Kosto Objektivi specifik 1.3					210,034,582	1,750,000	211,784,582	206,478,427	1,750,000	-3,556,155
	Kosto totale Qëllimi i Politikës I (objektiva specifike 1.1+1.2+1.3)					4,401,004,514	15,525,275,000	19,926,279,514	12,646,076,892	2,867,650,000	-4,412,552,622
Qëllimi i Politikës II: Krijimi i një mjedisi që lehtëson dhe inkurajon mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike											
Nr.	Titulli	Institucionet Përgjegjës		Periudha e Zbatimit		Kosto indikative					
		Institucioni drejtues	Institucionet pjesmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Korente	Kapitale	Total Kosto	Total BSH	Total FH	Hendeku Financiar
2.1	Objektivi Specifik 1 Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve të Arsimit të Lartë, institucioneve të pushtetit qendror dhe pushtetit	MFE, AKKSHI, MAS	AIDA, MSHNS, IAL, ML, NJQV	2023	2030						

Relacion shpjegues për projektvendimin, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

	vendor, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile nëpërmjet zgjerimit të kërkimit dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta. (Quadruple Helix Model)										
2.1.1	2.1.1 Masa 1. Krijimi i skemave inovatore për bashkëfinancimin e programeve të kërkimit shkencor që forcojnë bashkëpunimin me sektorin e biznesit për zgjidhjen e sfidave aktuale shoqërore	MFE	MAS, AIDA, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	2023	2030	0	1,776,000,000	1,776,000,000	1,076,000,000	0	-700,000,000
2.1.2	2.1.2 Masa 2 Informimi dhe njohja e të gjitha grupeve të interesit me mekanizmat dhe instrumentet e financimit shkencor	AKKSHI	MFE, MAS, AIDA, IAL	2023	2030	8,639,852	0	8,639,852	5,503,908	0	-3,135,944
2.1.3	2.1.3 Promovimi i modeleve të kërkimit shkencor në pjesëmarrjen e projekteve të përbashkëta (Quadruple Helix model)	AKKSHI	MAS, Ministrinë e Linjës	2023	2030	7,960,190	0	7,960,190	2,081,376	0	-5,878,814
2.1.4	2.1.4 Hartimi i udhëzuesve (që përfshijnë edhe protokollet dhe procedurat) për projekte të përbashkëta	AKKSHI	MAS	2023	2024	1,680,000	0	1,680,000	0	0	-1,680,000
2.1.5	2.1.5 Forcimi i kapaciteteve të IAL, përfaqësuesve të biznesit, institucioneve qendrore dhe vendore për hartimin e projekteve të përbashkëta	AKKSHI	MAS, IAL, AIDA, MFE, ML, NJQV	2025	2030	13,082,924	0	13,082,924	185,291	0	-12,897,633
2.1.6	2.1.6 Fuqizimi i kapaciteteve të strukturave të vlerësimit të projekteve të kërkimit shkencor me qëllim përfaqësimit të biznesit në këto struktura	MAS	AKKSHI	2025	2030	2,974,462	0	2,974,462	382,462	0	-2,592,000
	Kosto Objektivi specifik 2.1					34,337,428	1,776,000,000	1,810,337,428	1,084,153,037	0	-726,184,391
2.2	2.2 Objektivi Specifik 2: Përmirësimi i mekanizmave dhe rritja e mbështetjes së transferimit ndërkombëtar të teknologjisë (TNT).	DPPI, AKKSHI, MFE	MFE MAS, MBZHR, IAL MSHNS, ML,	2023	2030						
2.2.1	2.2.1 Plotësimi i bazës ligjore të nevojshme për transferimin ndërkombëtar të teknologjive (TNT)	DPPI	MAS, MFE dhe ML	2025	2030	7,550,166	0	7,550,166	6,315,364	0	-1,234,802
2.2.2	2.2.2 Fuqizimi i kapaciteteve të IAL-ve për transferimin ndërkombëtar të teknologjisë	AKKSHI	MFE MAS, MBZHR IAL MSHMS,	2025	2030	3,390,803	0	3,390,803	1,149,202	0	-2,241,601
2.2.3	2.2.3 Zhvillimi i infrastrukturave të reja që mundësojnë transferimin ndërkombëtar të teknologjive	MFE	MAS, MBZHR IAL MSHMS	2026	2030	25,084,665	29,894,200	54,978,865	0	29,342,200	-25,636,665
2.2.4	2.2.4 Promovimi i programeve ndërkombëtare që mbështesin transferimin e teknologjisë dhe njohja e të gjithë grupeve të interesit me mekanizmat, instrumentet e financimit/ mbështetjes së transferimit të ndërkombëtar të teknologjisë	AKKSHI	MAS, IAL, Ministrinë e Linjës	2024	2030	3,803,101	0	3,803,101	464,100	0	-3,339,001
2.2.5	2.2.5 Hartimi i udhëzuesve (që përfshijnë edhe protokollet dhe procedurat) për hartimin e projekteve të përbashkëta	AKKSHI	MAS	2026	2030	1,320,000	0	1,320,000	0	0	-1,320,000
	Kosto Objektivi specifik 2.2					41,148,735	29,894,200	71,042,935	7,928,666	29,342,200	-33,772,069
2.3	2.3 Objektivi Specifik 3: Rritja e rolit të shkencës dhe inovacionit në zhvillimin teknologjik	AKKSHI, AKFAL, MFE	MAS, DPPI, IAL MBZHR MIE ML AKSHI	2023	2030						

Relacion shpjegues për projektvendimin, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

2.3.1	2.3.1 Përmirësimi i një udhëzuesi (guideline) për lëvrimin e granteve për financimin e programeve kombëtare të kërkim zhvillimit dhe inovacionit	AKKSHI, AKFAL	MAS	2024	0	1,067,294	0	1,067,294	1,067,294	0	0
2.3.2	2.3.2 Promovimi i projekteve shkencore me ndikim në inovacion dhe zhvillimin teknologjik	AKKSHI	DPPI, IAL, MBZHR, MIE, ML	2023	2030	3,155,616	361,364,126	364,519,742	362,205,290	0	-2,314,452
2.3.3	2.3.3 Vlerësim i nevojave për zhvillimet teknologjike/inovacion me qëllim orientimin e projekteve kombëtare	AKKSHI	DPPI, IAL, MBZHR, MIE, MAS, , AKKSHI, ML	2026	2030	2,689,194	0	2,689,194	0	0	-2,689,194
2.3.4	2.3.4 artimi i projekteve për krijimin e qendrave rajonale të teknologjisë dhe inovacionit me qëllim mbështetjen e zhvillimit teknologjik	MFE	IAL, Ministrinë e Linjës, MIE	2026	2030	1,765,194	0	1,765,194	1,045,194	0	-720,000
	Kosto Objektivi specifik 2.3					8,677,298	361,364,126	370,041,424	364,317,778	0	-5,723,646
2.4	2.4 Objektivi Specifik 4: Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të qendrave të transferimit të teknologjisë për të avancuar njohuritë në një fushë të caktuar ose për të zhvilluar më tej teknologjinë	MBZHR, AKKSHI	IAL, MAS, MFE, MIE, DPPI, institute kërkimore jashtë IAL, ML	2023	2030						
2.4.1	2.4.1 Plotësimi i bazës ligjore për mirëfunksionimin e qendrave të transferimit të teknologjisë	MBZHR	IAL, MAS, MFE, MIE, DPPI, institute kërkimore jashtë IAL, ML	2023	2030	9,197,711	0	9,197,711	9,197,704	0	0
2.4.2	2.4.2 Fuqizimi i marrëdhënieve midis QTT dhe akademisë	MBZHR	IAL, AKKSHI	2023	2030	480,000	4,037,890,000	4,038,370,000	1,419,676,000	0	-2,618,694,000
2.4.3	2.4.3 Rritja e kapaciteteve të punonjësve të QTT mbi shkrimin e projekteve	AKKSHI	MBZHR	2024	2030	4,483,908	0	4,483,908	2,253,348	0	-2,230,560
2.4.4	2.4.4 Nxitja bashkëpunimit midis QTT dhe IAL përmes projekteve të përbashkëta	AKKSHI	IAL	2024	2030	4,658,908	70,000,000	74,658,908	73,882,906	0	-776,002
	Kosto Objektivi specifik 2.4					18,820,527	4,107,890,000	4,126,710,527	1,505,009,958	0	-2,621,700,562
	Kosto totale Qëllimi i Politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3+2.4)					102,983,988	6,275,148,326	6,378,132,314	2,961,409,439	29,342,200	-3,387,380,668

Qëllimi i politikës 3 - Promovimi i kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim për të siguruar një qasje didaktike me theksin në praktikën kërkimore dhe projektet.

Nr.	Titulli	Institucionet Përgjegjës		Periudha e Zbatimit		Kosto indikative					
		Institucioni drejtues	Institucionet pjesëmarrëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Korente	Kapitale	Total Kosto	Total BSH	Total FH	Hendeku Financiar
						Korente	Kapitale	Total Kosto	Total BSH	Total FH	
3.1	3.1 Objektivi Specifik 3.1 Reformimi i kurrikulës së shkencës në arsimin parauniversitar duke përfshirë STEM në edukim.	MAS	AKKSHI, ASCAP, MFE	2023	2030						

Relacion shpjegues për projektvendimin, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

3.1.1	3.1.1 Identifikimi i praktikave ndërkombëtare në drejtim të rishikimit të kurrikulave për përfshirjen e STEM në edukim	MAS	AKKSHI, ASCAP	2023	2030	724,420	0	724,420	4,420	0	-720,000
3.1.2	3.1.2 Përgatitja e stafit pedagogjik lidhur me realizimin e praktikave kërkimore dhe zhvillimin e projekteve kërkimore në sistemin parauniversitar	MAS	AKKSHI	2023	2030	6,162,455	0	6,162,455	2,062,457	0	-4,099,998
3.1.3	3.1.3 Promovimi dhe përfshirja e orëve jashtë-kurrikulare në arsimin parauniversitar mbi STEM	MAS	AKKSSHI MFE	2023	2030	26,397,401	0	26,397,401	25,721,000	0	-676,401
3.1.4	3.1.4 Përmirësimi i laboratorëve për zhvillimin e lëndëve STEM	MAS	MFE ASCAP	2023	2025	0	362,951,472	362,951,472	240,000,000	122,951,472	0
Kosto Objektivi specifik 3.1						33,284,276	362,951,472	396,235,748	267,787,877	122,951,472	-5,496,399
3.2	3.2 Objektivi Specifik 2: Sensibilizimi ne te gjitha nivelet e edukimit parauniversitar, per fuqizimin e rolit të rinjve ne kërkim dhe inovacion.	MAS, ASCAP	AKKSHI, MFE, Bashkitë, DPPI	2023	2030						
3.2.1	3.2.1 Angazhimi vazhdueshëm për mirinformimin e nxënësve të klasave të 9 dhe nxënësit e gjimnazeve për mundësitë që vijnë nga përfshirja në kërkim dhe inovacion	MAS	AKKSHI, MFE, Bashkitë, DPPI, ASCAP	2023	2030	4,748,808	0	4,748,808	2,475,214	0	-2,273,594
3.2.2	3.2.2 Promovimi dhe përfshirja e orëve/kurseve/aktiviteteve jashtë-kurrikulare për inovacionin në sistemin parauniversitar	ASCAP	MAS	2023	2030	16,389,061	0	16,389,061	2,059,060	0	-14,330,001
Kosto Objektivi specifik 3.2						21,137,869	0	21,137,869	4,534,274	0	-16,603,595
3.3	3.3 Objektivi Specifik 3: Zhvillimi i kompetencës digjitale	ASCAP	MAS	2023	2030						
3.3.1	3.3.1 Përmirësimi i kurrikulës, futja e TIK-ut në klasën e pare	ASCAP	MAS	2023	2030	68,090,389	0	68,090,389	64,590,388	0	-3,500,001
3.3.2	3.3.2 Zhvillimi i kompetencave digjitale të mësuesve përmes trajnimeve	ASCAP	MAS	2023	2030	12,905,804	0	12,905,804	3,345,805	0	-9,559,999
3.3.3	3.3.3 Përmirësimi i infrastrukturës, Smart lab-eve dhe pajisjeve të tjera të nevojshme	ASCAP	MAS	2023	2030	1,359,147	757,150,000	758,509,147	545,359,152	213,150,000	0
Kosto Objektivi specifik 3.3						82,355,340	757,150,000	839,505,340	613,295,345	213,150,000	-13,060,000
Kosto totale Qëllimi i Politikës III (objektiva specifike 3.1+3.2+3.3)						136,777,485	1,120,101,472	1,256,878,957	885,617,496	336,101,472	-35,159,994
Kosto Totale e Planit të Veprimit = QP I + QP II + QP III						4,640,765,987	22,920,524,798	27,561,290,785	16,493,103,827	3,233,093,672	-7,835,093,284

Relacion shpjegues për projektvendimin, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

Tregues të detajuar për kostimin të detajuar të strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030, si dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, jepen në tabelën nr. 1 sa vijon:

Tabela nr. 1	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Viti 2029	Viti 2030	Total Kostim Strategji
PBB në mije lekë , parashikuar për periudhën 2023-2030	2,176,100,000	2,285,879,000	2,401,850,000	2,473,905,500	2,548,122,665	2,624,566,345	2,703,303,335	2,784,402,435	
Shpenz Publike në mije lekë, parashikuar për periudhën 2023-2030	687,209,000	697,426,000	730,752,000	752,674,560	775,254,797	798,512,441	822,467,814	847,141,848	
Fondet e parashikuara, në mije lekë në draft strategji per periudhën 2023-2030	1,830,464	2,596,391	2,901,649	3,763,379	3,718,380	3,917,952	4,320,086	4,512,991	27,561,291
Në % ndaj PBB,	0.084%	0.114%	0.121%	0.152%	0.146%	0.149%	0.160%	0.162%	
Në % ndaj shpenzimeve publike,	0.27%	0.37%	0.40%	0.50%	0.48%	0.49%	0.53%	0.53%	

Relacion shpjegues për projektvendimin, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

PROPOZUESI

Evis KUSHI
MINISTËR